

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22, dhe në lidhje me nënparagrafin 2 nga Ligji i njëjtë i Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), neni 124, dhe neni 125, paragrafi (1) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.124/15), duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-81 datë 25.3.2026, për miratim të vendimit për anulim të Vendimit PA1 nr.08-66 datë 24.3.2026 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-1174/8 datë 25.3.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në vazhdimin e parë të seancës së 11-të mbajtur më 25.3.2026, miratoi:

VENDIM

1. **ANULOHET PLOTËSISHT** Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.08-66 datë 24.3.2026 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, për shkak se transmetuesi plotësisht e ka përmbushur detyrimin ligjor për pagesën e kompensimit vjetor të lejes për transmetim televiziv, përkatësisht ka kryer pagesën në shumë prej 118.740,00 (njëqin e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet) denarë, në pajtim me Faturën e dhënë nr.2026-100-0020 datë 12.1.2026 (nr ynë.ark.05-106/1 datë 12.1.2026).

2. Ky vendim është përfundimtar, dhe hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 10-të mbajtur më 10.3.2026, sipas Propozimit PA1 nr.08-66 datë 9.3.2026, për shkelje të nenit 80, paragrafi (5) dhe në lidhje me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6, në pajtim me nenin 83, paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), dhe në bazë të Konkluzionit nr.ark.02-916/2 datë 10.3.2026, inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (ShTR) TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, për shkak se transmetuesi nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv.

Në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes të ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, në pajtim me nenin 82, paragrafi (1) të LShMAAV, Agjencia drejtuar transmetuesit në fjalë ka dërguar Njoftimin PA1 nr.08-66 datë 10.3.2026, në të cilin i sugjeroj se nëse nuk e paguan plotësisht kompensimin vjetor të lejes, në pajtim me nenin 83, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, PA1 nr.08-66 datë 9.3.2026, do miraton Vendim për heqjen e lejes për

transmetim televiziv, sipas së cilës në pajtim me nenin 85, paragrafi (2) të LShMAAV, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i radiodifuzerëve.

Njoftimi PA1 nr.08-66 datë 10.3.2026, është dorëzuar me shkrim me postë rekomanduese drejtuar ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë dhe në formë elektronike në e-mail adresën zyrtare të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV dhe në regjistrin e radiodifuzerëve.

Duke marrë parasysh faktin se zotëruesi i lejes ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë dhe në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit PA1 nr.08-66 datë 9.3.2026, nga anëtarët e Këshillit të Agjencisë, nuk ka përmbushur detyrimin e parashikuar të nenit 80, paragrafi (5) të LShMAAV, Drejtori i Agjencisë, paraqiti Propozimin PA1 nr.08-66 datë 19.3.2026, sipas të cilit Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 dhe nenit 83, paragrafi (3) të LShMAAV, në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, nr.ark.02-1174/7 datë 24.3.2026, në seancën e 11-të mbajtur më 23.3.2026, miratoi Vendim PA1 nr.08-66 datë 24.3.2026, me të cilën i hiqet Leja PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023 për transmetim televiziv të ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, për shkak se zotëruesi i lejes nuk ka paguar plotësisht kompensimin e lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar ligjor.

Të njëjtën ditë (24.3.2026), transmetuesi në e-mail adresën zyrtare të Agjencisë njoftoi se llogaria e tij ishte zhbllokuar dhe deri me datë 25.3.2026, do të kryejë pagesën e kompensimit të lejes, për të cilën do të paraqesë dhe dëshmi. Dëshmi të pagesës së kryer të kompensimit të lejes, ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, më 25.3.2026 e dorëzoi në e-mail adresën zyrtare të Agjencisë.

Me datë 25.3.2026, nga Sektori për financa dhe logjistikë, drejtorit të Agjencisë iu dorëzua Njoftim me nr.ark.05-914/2 datë 25.3.2026, ku thuhet se ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, më 25.3.2026 ka kryer pagesë në shumë prej 118.740,00 (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet) denarë, duke paguar plotësisht kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv.

Në pajtim me nenin 17 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative (LPPA), organi publik është i detyruar t'u mundëson të gjitha palëve në procedurë t'i realizojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre dhe interesat ligjore në mënyrë më efektive dhe të lehtë. Organi publik i njofton palët për dispozitat ligjore që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes administrative, për të drejtat dhe detyrimet e tyre, duke përfshirë të gjitha informacionet lidhur me procedurën dhe i paralajmëron për pasojat juridike të veprimit ose mosveprimit të tyre.

Neni 124, paragrafi (2) të LPPA përcakton se akti administrativ mund në çdo kohë të shpallet i pavlefshëm sipas detyrës zyrtare.

Në nenin 125, paragrafi (1) të LPPA është përcaktuar se me shfuqizim të aktit administrativ dhe me shpalljen e pavlefshme të tij gjithashtu shfuqizohen dhe pasojat juridike që burojnë nga ky akt administrativ.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22, dhe në lidhje me nënparagrafin 2 nga neni i njëjtë të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nenit 124 dhe nenit 125, paragrafi (1) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-81 datë 25.3.2026, për miratim të vendimit për anulim të Vendimit PA1 nr.08-66 datë 24.3.2026 për marrjen e vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-1174/8 datë 25.3.2026, Këshilli i Agjencisë, në vazhdimin e parë të seancës së 11-të mbajtur më 25.3.2026, miratoi si në dispozitiv.

Në pajtim me nenin 24 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ky Vendim është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjzkatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

Përktheu: Antoneta Shabani